Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare

Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues

Tetor 2008

Në vrojtimin e parë të aktivitetit kreditues për vitin 2008[1], ekspertë të kredisë të bankave pjesëmarrëse, kanë raportuar për shtrëngim të standardeve të kredisë, e cila vijon që nga gjashtëmujori i dytë i vitit të kaluar. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, rezultatet e agreguara[2] të opinioneve të bankave të nivelit të dytë, tregojnë se bankat kanë qenë më të kujdesshme për kredinë akorduar bizneseve të mëdha se sa për kredinë akorduar bizneseve të vogla. Megjithatë, për kredinë akorduar korporatave, bankat parashikojnë zbutje në shkallën e shtrëngimit të standardeve në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Për sa i përket kërkesës së bizneseve për kredi, bankat gjykojnë se kërkesa neto për kredi në gjashtëmujorin e parë '08 është rritur, megjithëse ajo qëndron në nivel më të ulët se kërkesa e bizneseve në fund të vitit 2007.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, ekspertë të bankave kanë raportuar për një rritje të mëtejshme të standardeve edhe për kredinë e individëve. Balanca neto e standardeve për akordimin e kredisë dhënë individëve pritet të jetë negative dhe për gjashtëmujorin e dytë të vitit, si për kredi konsumi ashtu edhe për blerje të pasurive të patundshme. Megjithëse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 është regjistruar shtrëngim i kritereve për kredinë hipotekore, kjo është në një nivel më të ulët se shtrëngimi i kritereve për kredinë konsumatore. Kërkesa e individëve për kredi vijon të rritet, si për kredinë për banesa ashtu dhe për konsum, por me ritme më të ulta në krahasim me periudhën e mëparshme.

---

1 Në vrojtimin e rradhës të aktivitetit kreditues morën pjesë 10 banka, të cilat zotërojnë në total 94% të tregut të kredisë.

2 Rezultatet janë grumbulluar në formën e balancave neto – diferencë e balancave të peshuara të bankave që kanë raportuar lehtësim/rritje të standardeve/kërkesës dhe atyre që kanë raportuar shtrëngim/rënie të standardeve/kërkesës. Gajtë vrojtimit të rradhës peshat janë mbajtur të pandryshuara nga vrojtimi paraardhës, të bazuara në vlerën e portofolit të kredisë në muajin e fundit të vitit 2007, duke marrë në konsideratë vetëm segmentet e tregut të trajtuara në vrojtim (kredia dhënë bizneseve / individëve dhe në lekë / në valutë).

Kredia për bizneset

Standardet e kredisë. Bankat në përgjithësi kanë forcuar kriteret e akordimit të kredisë për bizneset në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008; balanca neto shënon -46% në krahasim me -10% në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2007. Lidhur me faktorët që kanë kontribuar në forcimin e kritereve, vendimet e Bankës së Shqipërisë, problemet specifike të sektorit ku vepron biznesi dhe situata e pritshme makroekonomike janë faktorët me kontributin më të lartë në shtrëngimin e kritereve të kredidhënies. Ndërkohë që mjaftueshmëria e kapitalit të bankës, niveli i konkurrencës së sistemit bankar dhe kreditë me probleme kanë pasur një kontribut më të ulët në shtrëngimin e standardeve të kredisë.

Grafik 1: Ndryshimet në standardet e kredisë të aplikuara në kreditë e bizneseve dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm (balanca neto[1)], në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.
Shënim 1. Balanca pozitive tregon për lehtësim të standardeve ose që faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve të kredidhënies, ndërsa balanca negative tregon për shtrëngimin e standardeve ose që faktori ka ndikuar në shtrëngimin e standardeve të kredidhënie.

Lidhur me kushtet e dhënies së kredisë, bankat kanë forcuar standardet e aplikuara për kredinë nëpërmjet rritjes së marzhit për kreditë me rrezik dhe rritjes së kërkesës për kolateral, në raport me madhësinë e huasë. Ndërkohë, marzhi mesatar (kreditë jo me rrezik) është ngushtuar dhe së bashku me kushtet e tjera, ka ndihmuar në kahun lehtësues të zbatimit të procedurave të kredisë.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, shtrëngimi i standardeve për kredinë, në total, vazhdon të jetë më i fortë për korporatat e mëdha (-65% për korporatat në krahasim me -31% për ndërmarrjet e vogla). Për sa i përket afatit të maturimit, bankat kanë shtrënguar pothuaj në të njëjtin nivel standardet edhe për kredinë për investime edhe kredinë për kapital qarkullues, me maturim më të vogël se një vit.

Tabelë 1: Tregues të ecurisë së standardeve të bankës për miratimin e kredisë.

	Total	**SME**	**Korporata**	**Kap.qarkullues**	**Investime**
Janë shtrënguar shumë	1 bankë	1 bankë	1 bankë	1 bankë	-
Janë shtrënguar disi	4 banka	3 banka	4 banka	5 banka	5 banka
Kryesisht të pandryshuar	3 banka	4 banka	5 banka	2 banka	4 banka
Janë lehtësuar disi	2 banka	2 banka	-	1 bankë	1 bankë
Janë lehtësuar shumë	-	-	-	1 bankë	-
Total	**10**	**10**	**10**	**10**	**10**

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kërkesa për kredi. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 kërkesa e bizneseve për hua nga bankat është pozitive, por me prirje në ulje në krahasim me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2007. Bankat kanë raportuar për kërkesë më të lartë nga ana e bizneseve të mëdha se sa nga ato të vogla dhe të mesme – balanca e kërkesës nga korporatat është +100%, në krahasim me balancën e kërkesës nga SME +51%.

Grafik 2: Kërkesa e bizneseve për kredi dhe kontributi i faktorëve të zgjedhur (balanca neto[2)], në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim 2: Balanca pozitive tregon për rritjen e kërkesës ose që faktori ka ndikuar në rritjen e kërkesës, ndërsa balanca negative tregon për uljen e kërkesës ose që faktori ka ndikuar në uljen e kërkesës për kredi.

Faktorët kryesorë që nxitën kërkesën e bizneseve edhe për vitin 2008 janë nevoja për financimin e investimeve dhe financimin e kapitalit qarkullues, balancat përkatëse janë +84% dhe +103%. Gjithashtu, vendimet e mara nga Banka e Shqipërisë dhe situata e përgjithshme makroekonomike ndikuan pozitivisht në kërkesën për hua bankare. Përdorimi i burimeve alternative të financimit (fondet e brendshme, huamarrje nga institucionet jobanka) ka pasur ndikim modest negativ, në rritjen e kërkesës për kreditim nga bankat tregtare.

Tabelë 2: Paraqitja e kërkesës për kredi.

	SME	Korporata	Kap.qarkullues	Investime
Dukshëm më e lartë	1 bankë	3 banka	3 banka	2 banka
Lehtësisht më e lartë	6 banka	3 banka	5 banka	5 banka
Pothuajse njësoj	3 banka	3 banka	2 banka	2 banka
Lehtësisht më e ulët	1 bankë	1 bankë	-	-
Dukshëm më e ulët	-	-	-	-
Total	**10**	**10**	**10**	**9**

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pritjet. Për sa i përket pjesës së dytë të vitit 2008, bankat parashikojnë ulje të intensitetit në shtrëngimin e standardeve të kredisë, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Përqasja ndaj bizneseve do të ketë tendenca disi më lehtësuese. Në veçanti për kredinë për investime edhe pse politika kredidhënëse do vazhdojë të jetë shtrënguese, pritet të jetë më e zbutur. Ndërkohë, për kreditë për kapital qarkullues dhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, standardet do të vazhdojnë të shtrëngohen më tej. Kërkesa pritet të rritet në gjashtëmujorin e dytë të vitit, më e lartë nga ana e bizneseve të vogla dhe të mesme se sa nga korporatat.

Kredia për individë

Standardet e kredisë. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, bankat raportojnë për një shtrëngim të standardeve dhe kushteve të kredisë për individë. Përqasja ndaj dy llojeve të kredisë për individët, megjithëse në kahun shtrëngues në të dy rastet, ka pasur intensitet të ndryshëm; standardet e kredisë për konsum janë forcuar më shumë (balanca -101% nga -12.4% në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2007) se sa standardet e kredisë për banesa (balanca -4% nga +34% në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2007).

Faktorët kryesorë që kontribuan në shtrëngimin e standardeve të kredisë për individë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 ishin gjendja financiare e individëve dhe situata në kreditë me probleme. Vendimet e mara nga Banka e Shqipërisë dhe zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme kanë dhënë kontribut disi më të ulët në shtrëngimin e procedurave të akordimit të kredive për individë. Gjatë pjesës së parë të vitit, bankat raportojnë se mjaftueshmëria e kapitalit të bankës, konkurrenca në sistemin bankar dhe niveli i likuiditetit të bankës, kanë luajtur rol modest në lehtësimin e procedurave.

Për sa i përket kushteve të miratimit të kredisë, politika shtrënguese e bankave u zbatua kryesisht nëpërmjet zgjerimit të marzhit për kreditë me rrezik më të lartë. Marzhi mesatar (për kreditë pa rrezik) është ngushtuar disi, duke lejuar zbatimin e një politike më lehtësuese të kredidhënies.

Grafik 3: Ndryshimet në standardet e kredisë të aplikuara në kreditë e individëve për banesa dhe për konsum dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm (balanca neto*), në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.
*) *Shih shënimin 1.*

Kërkesa për kredi. Bankat kanë raportuar në vrojtimin e rradhës se kërkesa neto e individëve për kredi ka pasur prirje në rënie që nga vrojtimi i kaluar, por mbetet në nivele pozitive. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 kërkesa e individëve për banesa mbetet në nivele më të larta se sa kërkesa e individëve për konsum. Përveç nevojës së individëve për të financuar blerjen e banesave dhe për financimin e konsumit, faktorë të tjerë që kanë kontribuar pozitivisht në kërkesën për kredi kanë qenë dhe zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme, besimi i konsumatorëve dhe kushtet e kreditimit të aplikuara nga bankat në veçanti. Përdorimi i burimeve alternative të financimit dhe vendimet e marra nga Banka e Shqipërisë, kanë dhënë kontributin e tyre në kahun ulës të kërkesës.

Grafik 3. Kërkesa e individëve për kredi dhe kontributi i faktorëve të zgjedhur (balanca neto*), në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.
*)*Shih shënimin 2*

Pritjet. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008, shtrëngimi i standardeve të kredisë për individët pritet të vazhdojë. Bankat presin që kërkesa e individëve për kredi gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2008 të mos ketë ndryshime të mëdha nga niveli i saj në gjashtëmujorin e parë.

Aktiviteti kreditues sipas monedhës.

Faktori kryesor që ka nxitur kërkesën për kreditim në valutë të huaj, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, për bizneset, është diferenca në normat e interesit (balanca afër vlerës maksimale + 197%). Bankat kanë paraqitur si faktor tjetër të rëndësishëm me kontribut pozitiv në rritjen e kërkesës për kreditim në valutë, dhe ndërgjegjësimin e ulët për rrezikun që lidhet me lëvizjet në kursin e këmbimit apo të normës së interesit, balanca +129%. Për sa i përket faktorëve që kanë nxitur kërkesën e individëve për kreditim në valutë të huaj, çmimet e të mirave të blera të shprehura në valutë të huaj dhe diferenca në normat e interesit janë dy faktorët me ndikimin më të theksuar (balanca +104% dhe +153%).

Pritjet e bankave për rritje të kredisë, si për kredinë në lekë, ashtu dhe për atë në valutë, janë pozitive për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008. Bankat parashikojnë një ritëm më të lartë rritjeje për kredinë në lekë (balanca +76% për kredinë në lekë nga +17% për kredinë në valutë). Pritjet për rritje të kredisë në lekë reflektojnë si politikat e brendshme të bankave tregtare, ashtu dhe politikën e ndjekur nga Banka e Shqipërisë për nxitjen e kreditimit në lekë. Perceptimi për ulje të ritmit të rritjes së kreditimit në euro, në gjysmën e dytë të vitit është shkaktuar nga parashikimi i bankave për një rritje të normës referencë të euros si dhe nga sensibilizimi i konsumatorëve për t'u mbrojtur më mirë nga rreziku i luhatshmërisë së kursit të këmbimit dhe normës së interesit.

Pritjet e bankave për ndryshimin e normës së interesit në gjashtë muajt e ardhshëm janë në rritje si për interesin e kredisë në lekë ashtu dhe për kredinë në valutë. Pritjet për këtë të fundit janë kthyer në pozitive nga një vlerë -58% në gjashtëmujorin e fundit të vitit 2007.